




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 292/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z. Nuhi Paqarizi – Kryetar, z. Blerim Dina –Referues dhe z. Goran Milenkovic-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Rexha” shpk& N. N. T “ABC”– Prishtinë, kundër aktivitetit të prokurimit: “Zgjerimi i rrugës nacionale N2 segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës (Veternik) Ura dhe Zgjidhja e nyjes që lidhë rrugën Nacionale N2 dhe N 25. 2 dhe kyqja e Autostradës R7”, me nr. prokurimi: 205-19-13115-5-11, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës, më datën 11 qershor 2019 mori këtë:

VENDIM

I. Hedhet poshtë si e jashtë afatshme ankesa e OE“Rexha” shpk& N. N. T “ABC”– Prishtinë, me nr. të protokollit 292/19, e datës: 07 qershor 2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zgjerimi i rrugës nacionale N2 segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës (Veternik) Ura dhe Zgjidhja e nyjes që lidhë rrugën Nacionale N2 dhe N 25. 2 dhe kyqja e Autostradës R7”, me nr. prokurimi: 205-19-13115-5-11, pasi që ankuesi ka parashtruar ankesë jashtë afatit ligjor në OSHP- në ditën e njëmbëdhjetë.

II. I LEJOHET autoritetit kontraktues–Ministria e Infrastrukturës që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zgjerimi i rrugës nacionale N2 segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës (Veternik) Ura dhe Zgjidhja e nyjes që lidhë rrugën Nacionale N2 dhe N 25. 2 dhe kyqja e Autostradës R7”, me nr. prokurimi: 205-19-13115-5-11, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 9. 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .

IV.Me qenë se ankesa e OE “Rexha” shpk & N. N. T “ABC”– Prishtinë, hudhet si e pa afateshme i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 07. 06. 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “Rexha” shpk & N. N. T “ABC”– Prishtinë, me nr. te protokollit 292/19 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i rrugës nacionale N2 segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës (Vetermik) Ura dhe Zgjidhja e nyjes që lidhë rrugën Nacionale N2 dhe N 25. 2 dhe kyqja e Autostradës R7”, me nr. prokurimi: 205-19-13115-5-11, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Pas pranimit të ankesës paneli shqyrtues ka mbajtur me datën: 11.06.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, dhe të gjithë parashtruesat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK ka publikuar njoftimin për kontratë me datën 19 mars 2019, Procedurë e hapur, me kriter për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Lëter standarde për tenderuesin e suksesëshëm është bërë me datën 22 maj 2019. OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 24 maj 2019. Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga AK është bërë me datën 27 maj 2019.

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar në nenin 9.1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave ku thuhet: 9.1 Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake

për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se, pas llogaritjes së afatëve nga data e vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim ankesa e OE ankues e parashtruar në OSHP është e jashtë afatëshme për shkak se e njëjta është parashtruar në ditën e njëmbëdhjetë e jo në ditën e dhjetë siç edhe thuhet në rregullën e lartpërmendur.

Andaj, duke pasur parasysh faktin se nga data 27 maj 2019 kur AK ka lëshuar vendimin për rishqyrtim e deri më datën 07 qershor 2019 kur OE ankues ka parashtruar ankesën në OSHP, kanë kaluar dhjetë ditë kalendarike për parashtrim të ankesës të paraparë me rregullat për dorëzim të ankesës dhe me nenin 108/A të LPP-së, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar është jashtë afatit ligjor dhe e njëjta hedhet poshtë si e pa afatshme.

Paneli Shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Ministria e Infrastrukturës
2. 1x1 OE "Rexha" shpk & N. N. T "ABC" – Prishtinë
3. Arkivës së OSHP-së